



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva – Ministry of Health

MENAXHIMI I INFEKSIONEVE TË PAKOMPLIKUARA TË TRAKTIT URINAR

UDHËRRËFYES KLINIK

Prishtinë, 2024

Përmbajtja

I.Hyrje.....	6
1.1. Qëllimi dhe fokusimi.....	6
1.2. Definicioni	6
1.3. Popullata e synuar.....	7
1.4. Dedikimi i udhërrëfyesit	7
1.5. Pyetjet mjekësore.....	7
II.Metodologjia.....	7
2.1. Burimet e financimit.....	9
2.2. Drafti final i udhërrëfyesit.....	9
2.3. Plan i për kohën e revidimit dhe përditësimit	9
III. Klasifikimi i infeksioneve të traktit urinar.....	9
3.1. Administrimi i antimikrobikëve	12
3.2. Bakteriuria asimptomatike te adultët (ABU).....	13
3.2.1. Parathënie.....	13
3.2.2. Etiologjia, epidemiologjia dhe patofiziologjia	13
3.2.3. Evaluimi diagnostik.....	14
3.2.4. Menaxhimi i sëmundjes.....	14
3.2.4.1. Pacientët pa faktorë të identifikuar të rrezikut	14
3.2.4.2. Pacientët e shëndetshëm me ABU dhe ITU rekurente.....	14
3.2.4.3. Gratë shtatzëna	15
3.2.4.3.1. A është i dobishëm trajtimi i ABU-se në gratë shtatzëna?.....	15
3.2.4.3.2. Cili tretman duhet aplikuar për trajtimin e ABU-se në shtatzëni....	15
3.2.4.3.2.1 Krahësimi i trajtimit me një dozë të vetme dhe trajtimit të shkurtër.....	15
3.2.4.4. Pacientët me faktor rreziku të identifikuar	16
3.2.4.4.1. Diabeti mellit	16
3.2.4.4.2. ABU te femrat pas menopauzës.....	16
3.2.4.4.3. Pacientë të moshuar të institucionalizuar	17
3.2.4.4.4. Pacientë me transplant të veshkës.....	17
3.2.4.4.5. Pacientë me disfunktion-rekonstruksione të traktit urinar të poshtëm.....	18

3.2.4.4.6. Pacientët me katetër urinar.....	19
3.2.4.4.7. Pacientët me ABU të nënshtruar ndaj vendosjeve/shkëmbimeve të kateterit....	19
3.2.4.4.8. Pacientët e imunokomprometuar me sëmundje të rënda, pacientët me kandiduri.....	19
3.2.4.5. Para procedurave kirurgjike urologjike.....	19
3.2.4.6. Para kirurgjisë ortopedike.....	20
3.2.4.7. Para ndërhyrjeve kardiokirurgjike	20
3.2.4.8. Menaxhimi farmakologjik.....	20
3.2.5. Përcjellja.....	20
3.2.6. Përmbledhja e evidencave dhe rekomandimeve për menaxhimin e ABU.....	21
3.2.6.1.Pyetje mjekesore	21
3.3. Cistiti i pakomplikuar	22
3.3.1. Hyrje	22
3.3.2. Etiologjia, epidemiologjia.....	22
3.3.3. Evaluimi diagnostik.....	22
3.3.3.1.Diagnoza klinike.....	22
3.3.3.2.diagnoza diferenciale.....	22
3.3.3.3.diagnoza laboratorike.....	22
3.3.3.4. Përmbledhje e rekomandimeve për evaluimin diagnostik të cistitit të pa komplikuar.....	23
3.3.3.4.1.Pyetejet mjekesore.....	23
3.3.4. Menaxhimi i sëmundjes.....	23
3.3.4.1. Cistiti në shtatzëni	24
3.3.4.2. Cistiti te meshkujt	24
3.3.4.3. Insuficienca renale	24
3.3.4.4. Përmbledhje e provave dhe rekomandimeve për terapinë antimikrobike për cistitin e pakomplikuar	25
3.3.4.4.1.Pyetje mjekesore.....	25
3.3.5.Analizat	26
3.4. ITU rekurente	26
3.4.1. Hyrje	26
3.4.2. Evaluimi diagnostik	26
3.4.3. Menaxhimi i sëmundjes dhe përcjellja	27

3.4.3.1. Përmbledhje e provave.....	27
3.4.3.2. Modifikimi i sjelljes.....	28
3.4.3.3. Profilaksa pa antibiotik	28
3.4.3.3.1. Zëvendësimet hormonale	28
3.4.3.3.2. Profilaksa imunoaktive	28
3.4.3.3.3. Profilaksa me probiotik	29
3.4.3.3.3.1. Profilaksa me boronicë	29
3.4.3.3.3.2. Profilaksa me D-manozë.....	30
3.4.3.3.3.3. Instilimi intravezikal.....	30
3.4.3.3.3.4. Methenamine hipurate	31
3.4.3.4. Profilaksa me antibiotik te ITU.....	31
3.4.3.4.1. Profilaksa me dozë të ulët kontinuale dhe profilaksa post koitale.....	31
3.4.3.4.2. Vetëdiagnostikimi dhe vetëtrajtimi	32
3.4.4. Përmbledhje e provave dhe rekomandimeve për diagnostikimin, evaluimin dhe trajtimin e ITUr.....	33
3.4.4.1. Pyetje mjekësore.....	34
3.5. Pielonefriti i pakomplikuuar	35
3.5.1. Evaluimi diagnostik.....	35
3.5.1.1. Diagnoza klinike.....	35
3.5.1.2. Diagnoza diferenciale.....	35
3.5.1.3. Diagnoza laboratorike	35
3.5.1.4. Diagnostikimi imazherik	35
3.5.2. Kërkimi i evidencës dhe rekomandimeve për evaluimin diagnostic te PN te pa komplikuuar.....	36
3.5.2.1. Pyetje mjekësore	36
3.5.3. Menaxhimi i sëmundjes	37
3.5.3.1. Trajtimi i pacientëve jashtëspitalor.....	37
3.5.3.2. Trajtimi ne spital.....	37
3.5.4. Përmbledhje e evidencave dhe rekomandimeve për trajtimin e PN të pa komplikuuar.....	38
3.5.5. Pyetje mjekësore	38
3.5.6. Kontrolli pas trajtimit	40
IV. Procesi i adaptimit të udhërrëfyesit	40

4.1. Grupi punues për adaptimin e UK.....	40
❖ 4.2. Deklarata e konfliktit të interesit	40
❖ VI. Shkurtesat dhe akronimet	41
❖ VII. Referencat.....	42

I. HYRJE

Infeksionet e traktit urinar (ITU) të pakomplikuara, janë ndër infeksionet bakteriale më të zakonshme që hasen në praktikën klinike. Ato prekin kryesisht traktin e poshtëm urinar, duke përfshirë fshikëzën urinare dhe strukturat e lidhura me të.

ITU-të e pakomplikuara paraqiten në individ të shëndetshëm pa anomali strukturore të traktit urinar, ose sëmundje shoqëruese të tilla si: DM, gjendjet imunosupresive, intervenimet kirurgjike, urologjike, shtatzënia.

Duke kuptuar aspektet kryesore të ITU-ve të pakomplikuara, profesionistët e kujdesit shëndetësor mund të optimizojnë kujdesin ndaj pacientit dhe të kontribuojnë në rezultatet më të mira të përgjithshme.

ITU janë rreth 4 herë më të shpeshta te femrat se te meshkujt. Rreth 40% e femrave zhvillojnë ITU gjatë jetës së tyre. Diagnoza e shpejtë dhe e saktë e ITU-ve të pakomplikuara është thelbësore për menaxhimin e duhur.

Ky udhërrëfyes klinik shqyrton ITU-të e pakomplikuara duke përfshirë paraqitjen e tyre klinike, diagnozën dhe qasjen e trajtimit.

1.1. Qëllimi dhe fokusimi

Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është të ofrohen rekomandime praktike për parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve të traktit urinar (ITU). Për të ndihmuar profesionistët shëndetësorë, përfshirë mjekët e kujdesit parësor shëndetësorë: Nefrologët, Urologët, Pediatërit, Internistët, Infektologët, Gjinekologët dhe të gjitha grupet relevante profesionale. Ky udhëzues synon gjithashtu të trajtojë aspektet e rëndësishme të shëndetit publik të kontrollit të infeksionit dhe kujdesit antimikrobik.

1.2. Definicioni

Infeksioni i traktit urinar i pakomplikuar është infeksion akut, sporadik ose i përsëritur i traktit të poshtëm (cistit i pakomplikuar) dhe/ose i sipërm (pielonefriti i pakomplikuar). Është i kufizuar te gratë jo shtatzëna pa anomali të njohura përkatëse anatomike dhe funksionale brenda traktit urinar ose sëmundje shoqëruese, të tilla si: DM, gjendjet me imunitet të komprometuar, ndërhyrjet kirurgjike urologjik [3].

1.3. Popullata e synuar

Ky udhërrëfyes, synon trajtimin e personave me infeksione të traktit urinar të pakomplikuara, ku janë të përfshirë të gjitha grupmoshat (fëmijët, adoleshentët, të rriturit dhe të moshuarit).

1.4. Dedikimi i Udhërrëfyesit

UK i dedikohet ofruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore, menagjerëve të institucioneve shëndetësore, departamenteve farmaceutike në MSH, SHSKUK, përfshirë të gjitha nivelet e saj, si dhe QKUK - në si qendër terciare.

Poashtu, i dedikohet edhe sektorit të mjekësisë familjare (qendrave të mjekësisë familjare, spitaleve dhe ambulancave private që ushtrojnë veprimtari sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe të sëmureve, familjarëve dhe kujdestarëve të tyre).

1.5. Pyetejet mjekësore

1.5.1. Çka është infeksioni i traktit urinar i pakomplikuar?

1.5.2. Cilat pjesë të traktit urinar preken te infeksioni urinar i pakomplikuar?

1.5.3. Cili është menaxhimi më efektiv i bakteriurisë asimptomatike?

1.5.4. Kur është infeksioni urinar rekurent?

1.5.5. Çka është pielonefriti i pakomplikuar?

1.5.6. Menaxhimi i pielonefritit të pakomplikuar?

1.5.7. Diagnostikimi dhe menaxhimi i cistitit të pakomplikuar?

II. Metodologjia

Ky udhërrëfyes, është hartuar nga grupi punues multidiciplinar dhe multiprofesional i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë - Republika e Kosovës:

Të gjithë anëtarët e grupit punues para hartimit të këtij udhërrëfyesi, kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë konflikt interesi, për çka edhe kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit.

Ky udhërrëfyes, është hartuar në përputhje me metodologjinë standarde të procesit të adaptimit të udhërrëfyesëve duke u shërbyer me dokumentin AGREEII, dhe marrja e vendimeve dhe rekomandimeve nga anëtarë të grupit punues është bërë me konsensus [me pëlqim të plotë të të gjithë anëtarëve të grupit punues].

Grupi punues ka rishikuar udhërrëfyesët klinik të publikuar në vitet e fundit, me rekomandime të qëndrueshme dhe me shkallë të lartë të evidencave, si dhe është referuar në statistikën më të reja.

Udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna në udhërrëfyesin klinik janë bazuar në literaturën ndërkombëtare, si dhe përshkrimi i rekomandimeve është bërë sipas literaturës së

përzgjedhur. Janë shqyrtuar shumë udhërrëfyes klinik praktik dhe përfundimisht grupi punues është përcaktuar për udhërrëfyesit në vijim:

<https://uroweb.org/guidelines/urological-infections>

Metodologjia e përdorur në literaturën e përzgjedhur për adaptimin e udhërrëfyesit, referohet në provat që mbështesin referencat; prova klinike të rastësishme, studime në të cilat përcillen subjektet gjatë gjithë kohës [grupet e kontrollit dhe grupet e trajtimit].

Të dhënat mbi epidemiologjinë, diagnozën dhe trajtimin e infeksioneve urinare të pakomplikuara u realizuan përmes MEDLINE, citimeve, hulumtimeve për trajtime specifike.

Për Udhëzuesit e Infeksioneve Urinare 2024, u identifikuan prova të reja dhe relevante. Këto prova u grumbulluan dhe u vlerësuan përmes një vlerësimi të strukturuar të literaturës për seksionet 3.3. Bakteriuria asimptomatike te të rriturit.

Janë kryer kërkime të gjera dhe gjithëpërfshirëse në literaturë, që mbulojnë këto seksione. Bazat e të dhënave të kërkuara përfshinin- Medline, EMBASE dhe Cochrane. Kornizat kohore të mbuluara dhe numri i regjistrimeve unike të identifikuar, të marra dhe të kontrolluara për rëndësinë për secilin seksion ishin:

Seksioni	Nr. i të dhënave të regjistruara	Periudha kohore e kërkimit
3.3. Bakteriuria asimptomatike te adultët	1,503	1 Dhjetor 2016- 1 Qershor 2023

Strategjitë hulumtuese mund t'i gjeni on-line: <https://uroweb.org/guidelines/urological-infections/publications- appendices>.

Rekomandimet brenda Udhëzuesve janë zhvilluar nga panelet për t'i dhënë përparësi vendimeve të bazuara në kujdesin klinik. Fuqia e secilit rekomandim përcaktohet nga ekuilibri midis pasojave të dëshirueshme dhe të padëshirueshme të strategjive alternative të menaxhimit, cilësisë së provave (përfshirë sigurinë e vlerësimeve) dhe natyrës, si dhe ndryshueshmërisë së vlerave dhe preferencave të pacientit. Ky proces vendimarrës, i cili mund të rishikohet në formularët e vlerësimit të forcës që shoqërojnë çdo deklaratë udhëzuese, trajton një numër elementësh kyç, si:

1. Cilësinë e përgjithshme të provave që ekzistojnë për rekomandimin [3];
2. Madhësinë e efektit (efektet individuale ose të kombinuara);
3. Sigurinë e rezultateve (precizitetin, konsistencën, heterogjenitetin dhe faktorë të tjerë të lidhur statistikor ose studimor);
4. Ekuilibrin ndërmjet rezultateve të dëshirueshme dhe të padëshirueshme;
5. Ndikimin dhe sigurinë e vlerave, si dhe preferencave të pacientit në ndërhyrje.

Rekomandimet e fuqishme, zakonisht tregojnë një shkallë të lartë të cilësisë së provave dhe/ose një ekuilibër të favorshëm të përfitimit ndaj dëmit dhe preferencës së pacientit.

Rekomandimet e dobëta, zakonisht tregojnë disponueshmërinë e provave me cilësi më të ulët, dhe/ose ekuilibrin e paqartë midis përfitimit dhe dëmit, dhe pasigurinë ose ndryshueshmërinë e preferencës së pacientit [4].

Informacionet shtesë për metodologjinë dhe një listë e shoqatave që mbështesin Udhëzuesit e EAU mund të gjenden në faqen online: <https://uroweb.org/eau-guidelines/methodology-policies>.

2.1. Burimet e financimit

Hartimi i udhërrëfyesit është mbështetur nga MSH.

2.2. Drafti final i udhërrëfyesit

Sipas procesit të përcaktuar është analizuar nga dy recenzentë:

Dr. Vjollca Godanci – Nefrologe, Kryetare e Shoqatës së Nefrologëve të Kosovës.

Dr. Bujar Frangu – Urolog, Kryetar i Shoqatës së Urologëve të Kosovës.

2.3. Plani për kohën e revidimit dhe përditësimit

UK për menaxhimin e infeksioneve urinare të pakomplikuara, duhet të revidohet dhe të përditësohet pas 4-viteve, e në rast të të dhënave të reja shkencore kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër. Procedura e revidimit përcaktohet nga MSH, ndërsa UK përditësohet në bazë të dëshmive të fundit të publikuara si dhe kërkesave dhe rekomandimeve nga përdoruesit e UK.

III. Klasifikimi i infeksioneve të traktit urinar


Ekzistojnë sisteme të ndryshme klasifikimi të Infeksioneve të traktit urinar- ITU. Më së shpeshti të përdorura janë ato të zhvilluara nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) [5], Shoqata e Sëmundjeve Infektive të Amerikës (IDSA) [6], Shoqata Evropiane e Mikrobiologjisë Klinike dhe Sëmundjeve Infektive (ESCMID) [7] si dhe Administrata Amerikane e Ushqimit dhe Barnave (FDA) [8, 9].

Udhëzuesit e tanishëm - aktual për ITU, përdorin shpesh konceptin e ITU të pakomplikuara dhe të komplikuar me një numër modifikimesh (Figura 1).

Në vitin 2011, Seksioni i Infeksioneve në Urologji EAU propozoi sistemin e klasifikimit ORENUC bazuar në paraqitjen klinike të ITU, nivelin anatomik të ITU, shkallën e ashpërsisë

së infeksionit, kategorizimin e faktorëve të rrezikut dhe disponueshmërinë e terapisë së përshtatshme antimikrobiale.

Figura 1: Koncepti i infeksioneve të pakomplikuara të traktit urinar dhe infeksioneve të komplikuara të traktit urinar



Klasifikimi i ITU i përshtatur në Udhërrëfyesit e EAU ITU

Klasifikimi i ITU	
ITU-të e pakomplikuara	ITU akut, sporadik ose i përsëritur i traktit të poshtëm (cistit i pakomplikuara) dhe/ose i sipërm (pielonefriti i pakomplikuara), i kufizuar te gratë joshtatzëna pa anomali të njohura përkatëse anatomike dhe funksionale brenda traktit urinar ose sëmundje shoqëruese.
ITU-të e komplikuara	Të gjitha ITU-të, të cilat nuk përkufizohen si të pakomplikuara, do të thotë në një kuptim më të ngushtë ITU në një pacient me një shans të shtuar për një kurs të komplikuara: d.m.th të gjithë burrat, gratë shtatzëna, pacientët me anomali anatomike ose funksionale përkatëse të traktit urinar, kateterët urinar të vendosur, sëmundjet e veshkave dhe/ose me sëmundje të tjera shoqëruese të imunokompromentimit, për shembull, diabetit.
ITU-të rekurente	ITU-të rekurente të komplikuara dhe të pakomplikuara, me një frekuencë; 3 infeksione brenda 1-viti ose 2 infeksione brenda 6-muajve.
ITU-të të shoqëruara nga kateteri	Te personat që janë të katetrizuar apo iu është vendosur katetri urinar para 48 orëve.
Urosepsa	Urosepsa është një gjendje jetëkërcënuese që paraqet çrregullim të funksionit të organeve, e shkaktuar nga çrregullimi i përgjigjes së pacientit ndaj infeksionit, që ka origjinë nga trakti urinar apo organet gjenitale mashkullore.

3.1. Administrimi i antimikrobikëve

Edhe pse përfitimet për pacientët nga përdorimi i antibiotikëve janë të qarta, përdorimi i tepërt dhe keqpërdorimi kanë kontribuar në rritjen e problemit të rezistencës midis baktereve uropatogjene, e cila është një kërcënim serioz për shëndetin publik.

Në spitalet me shërbime urgjente, 20-50% e antibiotikëve të përshkruar janë ose të panevojshëm ose të papërshtatshëm . Si përgjigje, një iniciativë mbarëbotërore kërkon të përfshijë programet e kujdesit antimikrobial në kujdesin shëndetësor.

Mbikëqyrja antimikrobiale synon të optimizojë rezultatet klinike dhe të sigurojë terapi me kosto efektive duke minimizuar pasojat e padëshiruara të përdorimit antimikrobial siç janë: infeksionet e lidhura me kujdesin shëndetësor duke përfshirë *Clostridioides difficile*, toksicitetin, përzgjedhjen e organizmave virulent dhe shfaqjen e shtameve bakteriale rezistente .

Menaxhimi i antimikrobikëve ka dy grupe kryesore veprimesh:

Grupi i parë, kërkon përdorimin e kujdesit të rekomanduar në nivelin e pacientit në përputhje me udhëzimet.

Grupi i dytë, përshkruan strategjitë për të arritur respektimin e udhëzimeve të mandatuara. Këto përfshijnë veprime bindëse si edukimi dhe reagimet së bashku me kufizimin e disponueshmërisë së lidhur me formularët lokalë.

Një studim i *Cochrane*, i efektivitetit të ndërhyrjeve për të përmirësuar praktikën e përshkrimit të antibiotikëve për pacientët e shtruar në spital, i përditësuar në vitin 2017, gjeti prova me siguri të lartë se ndërhyrje të tilla janë efektive në rritjen e respektimit të politikës së antibiotikëve që çojnë në reduktimin e kohëzgjatjes së trajtimit me antibiotikë dhe se mund të reduktojnë gjithashtu qëndrimin në spital. . Rishikimi nuk gjeti prova që reduktimi i përdorimit të antibiotikëve rrit vdekshmërinë .

Komponentët e rëndësishëm të programeve të administrimit të antimikrobikëve janë :

- trajnimi i rregullt i stafit për përdorimin më të mirë të agjentëve antimikrobikë;
- respektimin e udhëzimeve lokale, kombëtare ose ndërkombëtare;
- vizita të rregullta në repart dhe konsultime me mjekë infeksionistë dhe mikrobiologë klinikë;
- auditimi i aderimit dhe rezultateve të trajtimit;
- monitorim i rregullt dhe reagime ndaj përshkruesve të performancës së tyre dhe profileve lokale të rezistencës ndaj patogjenit.

Një rishikim sistematik i 2016-ës i provave për efektivitetin e ndërhyrjeve të ndryshme të Administrimit Antimikrobik në institucionet e kujdesit shëndetësor, identifikoi 145 studime me nëntë objektiva të kujdestarisë.

Terapia empirike e drejtuar nga udhëzimet duke përdorur një zgjedhje të kufizuar të antibiotikëve dhe duke përfshirë de-përshkallëzimin, kalimin intravenoz në oral, monitorimin e barnave terapeutike dhe konsultimin pranë shtratis, rezultoi në një reduktim relativ të rrezikut prej 35% (95% CI 20-46%) të vdekshmërisë.

Përdorimi i de-përshkallëzimit (përshtatur me një agjent me spektër më të ngushtë), tregoi një RRR prej 56% (95% CI 34 – 70%) për vdekshmërinë .

Për të lehtësuar iniciativat dhe auditimin lokal, u zhvillua një grup treguesish të vlefshëm, të besueshëm dhe të zbatueshëm të cilësisë së përdorimit të antibiotikëve në trajtimin e pacientëve të shtruar në spital me ITU të komplikuar .Përdorimi i tij në Holandë, duket se rezulton në shkurtimin e qëndrimit në spital .

Një kërkim i literaturës i *Pubmed* nga prilli 2014 deri në shkurt 2017, nuk identifikoi prova të mtejshme të kontrolluara të rastësishme (RCT) në lidhje me programet e kujdestarisë për ITU. Studimet për të siguruar prova me cilësi të lartë të efektivitetit të programeve të kujdestarisë në pacientët urologjikë janë të nevojshme urgjentisht.

3.2. Bakteriuria asimptomatike te adultët

3.2.1.Parathënie Rritja urinare e bakterieve në një individ asimptomatik (bakteriuri asimptomatike-ABU) është e zakonshme dhe korrespondon me një kolonizim komenzal . Studimet klinike kanë treguar se ABU mund të mbrojnë kundër superinfektimit të ITU, kështu që trajtimi i ABU duhet të kryhet vetëm në rastet e përfitimit të provuar për pacientin për të shmangur rrezikun e përzgjedhjes së rezistencës antimikrobike dhe çrrënjësjes së një shtame ABU potencialisht mbrojtëse . Qëllimi i këtij seksioni është të mbështesë klinikistin për të vendosur se kur ABU duhet ose nuk duhet të trajtohet.

3.2.2. Epidemiologjia, etiologjia dhe patofiziologjia

ABU shfaqet në rreth 1-5% të femrave të shëndetshme para menopauzes, duke u rritur në 4-19 % në femrat dhe meshkujt e moshuar ndryshe të shëndetshëm, 0.7-27% në pacientët me Diabet, 2-10% në gratë shtatzëna, 15-50% në popullatat e moshuara të institucionalizuara dhe në 23-89 % në pacientët me lëndime të shtyllës kurrizore .

ABU te meshkujt e rinjë është e pazakont, por kur zbulohet duhet të merret parasysh prostatiti kronik bakterial l. Spektri i bakterieve në ABU është i ngjashëm me speciet që gjenden në ITU të pakomplikuara ose të komplikuara, në varësi të pranisë së faktorëve të rrezikut.

3.2.3. Evaluimi diagnostik

ABU përcaktohet nga një kampion i urinës në mes të rrjedhjes që tregon rritje bakteriale >10 CFU /mL në dy mostra të njëpasnjëshme të gratë , dhe në një kampion të vetëm të burrat në një individ pa simptoma të TU.

Cistoscopia dhe imazhi i traktit të sipërm urinar nuk është i detyrueshëm nëse historia mjekësore është pa vërejtje.

Nëse zbulohet rritja e vazhdueshme e bakterieve që prodhojnë ureazë, d.m.th. proteus mirabilis, duhet të përjashtohet formimi i gurëve në traktin urinar . Te meshkujt duhet të kryhet një ekzaminim digjital rektal për të hetuar mundësinë e sëmundjeve të prostatës .

3.2.4. Menaxhimi i sëmundjes

3.2.4.1. Pacientët pa faktorë të identifikuar të rrezikut , bakteriuria asimptomatike nuk shkakton sëmundje ose dëmtim të veshkave . Në një studim prospektiv, jo-randomizues, ku është hulumtuar efekti i trajtimit të bakteriurisë asimptomatike te të rriturit, jo –diabetik, te gratë jo –shtatëzëna , është gjetur se nuk ka asnjë ndryshim në shkallën e ITU-ve simptomatike.

Për më tepër, siç është vërtetuar trajtimit i ABU-së së panevojshme në shumicën e nëngrupeve të pacientëve me rrezik të lartë, ekziston një panel konsensusi , i cili rezultatet e këtyre nëngrupeve mund t'i aplikojë edhe te pacientët pa faktorë rreziku të identifikuar. Prandaj, screeningu dhe trajtimi i ABU-së nuk rekomandohet te pacientët pa faktorë rreziku.

3.2.4.2. Pacientët e shëndetshëm me ABU dhe ITU rekurente

Në një hulumtim, është vërejtur efekti i trajtimit të ABU-së në pacientet femra me ITU asimptomatike rekurente pa faktorë predisponues , dhe është vërejtur një rritje e rrezikut për një episod të mëvonshëm të ITU simptomatike, krahasuar me pacientët të cilët nuk janë trajtuar me antibiotik (RR 0.28, 95% CI 0.21 to 0.38; n=673). Efekti mbrojtës i zhvillimit spontan të ABU-së, mund të përdoret si pjesë e parandalimit te pacientet femra me ITU simptomatike rekurente, prandaj trajtimi i ABU nuk rekomandohet.

3.2.4.3 Gratë shtatzëna

3.2.4.3.1 A është i dobishëm trajtimi i ABU-së te gratë shtatzëna ?

Janë identifikuar 12 RCT (randomized control trials) hulumtime, që kanë krahasuar trajtimin e ABU-së me placebo ose pa trajtim , me doza të ndryshme të antibiotikëve, 10 të publikuara para vitit 1988 dhe një në vitin 2015.

Janë gjetur 11 RCT (n = 2,002), (randomized control trials) mbi shkallën e ITU-ve simptomatike. Trajtimi me antibiotikë reduktoi ndjeshëm numrin e ITU-ve simptomatike krahasuar me placebo ose pa trajtim (RR mesatar 0.22 CI 0.12 deri në 0.40).

Në 6 RCT janë raportuar se është bërë zgjidhja e problemit të bakteriurisë.

3.2.4.3.2. Cili tretman duhet aplikuar për trajtimin e ABU-së në shtatzëni ?

Janë identifikuar gjashtëmbëdhjetë RCT, që kanë krahasuar efikasitetin e trajtimeve të ndryshme me antibiotikë në gratë shtatzëna me ABU.

Studimet krahasuan regjime të ndryshme të antibiotikëve, me regjime të njëjta të antibiotikëve me kohëzgjatje të ndryshme. Kohëzgjatja e trajtimit varionte, nga një dozë e vetme deri te trajtimi i vazhdueshëm (deri në lindje). Për qëllime praktike, përdoret strategjia e grupimit nga publikimi *Cochrane* i botuar nga *Ëidmer et al.* i miratuar me disa modifikime.

Ky grup i mëposhtëm i trajtimeve është përdorur për krahasim:

1. Dozë e vetme (një ditë)
2. Trajtim i shkurtër (2-7 ditë)
3. Trajtim i gjatë (8-14 ditë)
4. Trajtim i vazhdueshëm (deri në lindje të foshnjës)

Nëntë studime krahasuan trajtimin me një dozë të vetme dhe trajtimin e shkurtër, një studim krahasoi trajtimin me një dozë të vetme dhe trajtimin e gjatë , dhe një studim tjetër krahasoi trajtimin e gjatë me trajtimin e vazhdueshëm .

3.2.4.3.2.1 Krahasimi i trajtimit me një dozë të vetme dhe trajtimit të shkurtër

Tri RCT hulumtime, raportuan për shkallën e ITU-ve simptomatike, pa dallime të rëndësishme (mes dy kohëzgjatjeve të trajtimit) (mesatarja RR 1.07, 95% CI 0.47 deri 2.47; n=891). Nëntë RCT hulumtive raportuan mbi normën e përmirësimit të ABU-ve, pa dallim të rëndësishëm midis dy kohëzgjatjeve të tretmanit (average RR 1.07, 95% CI 0.47 to 2.47; n=891).

Gjashtë RCT raportuan mbi efektet anësore të terapisë .

Trajtimi me një dozë të vetme ka treguar më pak efekte anësore në krahasim me trajtimin e shkurtër me antibiotik (mesatarja RR 0.40, 95% CI 0.22 to 0.72; n=458). Tri RCT hulumtime, kanë raportuar mbi shkallën e lindjeve të parahkohshme, pa dallim signifikant mes dy llojeve të trajtimit (mesatarja RR 1.16, 95% CI 0.75 to 1.78; n=814).

Ka pasur dukshëm më shumë foshnje me peshë të ulët të lindjes te pacientet e trajtuara me një dozë të vetme krahasuar me trajtimin e shkurtër (mesatarja RR 1.65, 5% CI 1.06 deri 2.57; n=714).

Sipas analizës së të dhënave, trajtimi me një dozë të vetme ishte i lidhur me një shkallë dukshëm më të ulët të efekteve anësore, por një shkallë dukshëm më të lartë të lindjeve të foshnjeve me peshë të ulët. Është identifikuar një meta-analizë mbi përdorimin e Fosfomycin-trometamolit me dozë të vetme te femrat me ITU të pakomplikuara ose ABU.

Studimi identifikoi pesë RCT hulumtime duke përfshirë 577 pacienta. Shkalla e zgjidhjes së ABU-së në gratë shtatzëna të trajtuara me Fosfomycin me një dozë të vetme nuk ndryshonte nga pacientet tjera që morën antibiotikë të tjerë (OR 1.32 ,95% CI 0.78-2.22, P=0.30). Trajtimi i shkurtër ose trajtimi me një dozë të vetme me Fosfomycin rekomandohet të aplikohet për trajtimin e ABU në shtatzëni; megjithatë duhet të theksohet se cilësia e provave shkencore që mbështesin këtë rekomandim është e ulët.

3.2.4.4. Pacientët me faktorë rreziku të identifikuar

3.2.4.4.1. Diabeti mellit

Diabeti mellitus, edhe kur është i rregulluar, lidhet me një frekuencë më të lartë të ABU-së . Një hulumtim RCT, tregoi se çrënjosja e ABU-së nuk e zvogëloi rrezikun e ITU simptomatike dhe komplikimeve te pacientët me Diabet. Për më tepër, ABU e patrajtuar nuk lidhet me nefropatitë diabetike. Prandaj, depistimi dhe trajtimi i ABU te pacientët me Diabet mellitus të kontrolluar nuk rekomandohet. Megjithatë, diabeti i parregulluar është një faktor rreziku për UTI simptomatike dhe komplikime.

3.2.4.4.2. ABU te femrat pas menopauzes

Gratë e moshuara kanë një incidencë të shtuar për ABU .

Katër RCT krahasuan trajtimin me antibiotikë të ABU me Placebo ose pa trajtim, në një grup të femrave pas menopauzës, me doza të ndryshme antibiotiku .

Gratë në këto studime ishin kryesisht banore në shtëpi pleqësh, gjë që mund të paragjykohet rezultati i kësaj analize. Tre RCT të raportuara për shkallën e UTI-ve simptomatike (RR mesatarja 0.71, 95% CI 0.49 deri në 1.05; 208 gra) dhe zgjidhja e bakteriurisë (RR mesatar 1.28, 95% CI 0.50 deri në 3.24; 203 gra), pa përfitime të rëndësishme të trajtimit me antibiotikë.

Prandaj, trajtimi me antibiotik i ABU në gratë pas menopauzës nuk është i domosdoshëm, dhe duhet të menaxhohet si për gratë para menopauzës.

3.2.4.4.3. Pacientë të moshuar të institucionalizuar

Te pacientët e moshuar të institucionalizuar (spitale, shtëpi pleqësh), shkalla e ABU-së është 15-50% . Diagnoza diferenciale e ABU-së nga ITU simptomatike është e vështirë te pacientët me shumë sëmundje dhe te pacientët me sëmundje mendore, dhe kjo ndoshta është për shkak të trajtimit të panevojshëm me antibiotikë .

Shtatë RCT krahasuan trajtimin me antibiotik të ABU-së me placebo kontrollë ose pa trajtim në pacientët e moshuar, me doza dhe regjime të ndryshme të antibiotikëve.

Tre RCT raportuan për shkallën e ITU-ve simptomatike .

Trajtimi me antibiotikë nuk ishte i dobishëm në uljen e shkallës së UTI-ve simptomatike në krahasim me placebo ose pa trajtim (mesatar RR 0,68, 95% CI 0,46 deri në 1,00; n=210).

Gjashtë RCT raportuan për zgjidhjen e bakteriurisë .

Nuk kishte asnjë përfitim të rëndësishëm nga trajtimi me antibiotik në krahasim me placebo në zgjidhjen e ABU-së (mesatare RR 1.33, 95% CI 0,63 deri në 2,79; n=328).

Një RCT krahasoi shkallët e inkontinences në këtë grup pacientësh përpara dhe pas çrrënjësjes së ABU-së dhe nuk gjeti asnjë efekt të trajtimit me antibiotik .

Një rishikim sistematik i mëvonshëm dhe një meta-analizë e nëntë RCT-ve zbuloi se trajtimi me antibiotik i ABU-së në këtë grup ishte i lidhur dukshëm me më shumë efekte anësore pa asnjë përfitim klinik. Prandaj, shqyrtimi dhe trajtimi i ABU-së nuk rekomandohet në këtë grup pacientësh.

3.2.4.4.4. Pacientët me transplante renale

Dy RCT dhe dy studime retrospektive, krahasuan efektin e trajtimit me antibiotik dhe pa trajtim te pacientët me veshkë të transplantuara .

Meta-analiza e dy RCT-ve nuk gjeti ndonjë benefit trajtimi me antibiotik në aspektin e reduktimit të ITU simptomatike, 12 dhe 22 muaj pas transplantimit të veshkave (RR 0,86, 95% CI 0,51 deri në 1,45; n=200).

Dy studimet retrospektive arritën në të njëjtin përfundim. Për më tepër, nuk ka pasur dallime të rëndësishme në shkallën e zgjidhjes së ABU-së, humbjes së transplantit ose ndryshimit të funksionit renal gjatë një follow-up prej 24 muaj.

U identifikuan edhe dy RCT të tjera , një studim observues dhe dy rishikime dhe meta-analiza sistematike .

RCT e parë, raporto i se gjatë 2 muajve të parë pas transplantimit të veshkave incidenca e rrezikut për ITU (25% kundrejt 10%, HR 2.8, 95% CI 0.8-9.1, p=0.07) dhe pielonefrit (15% kundrejt 2.5%, HR 6.5, 95% CI 0.8-54.7, p=0.08) ishte më e lartë në pacientët që merrnin antibiotik për trajtim për ABU, kundrejt pacientëve që nuk morën trajtim .

Në RCT-në e dytë, nuk kishte asnjë ndryshim në grupin që kishin pielonefritin akut të graftit midis terapisë dhe jo terapisë, (12.2% vs 8.7%, RR 1.40, 95% CI 0.40-4.87) gjatë vitit të parë pas transplantimit. Por, megjithatë, normat e rezistencës antimikrobike ishin më të larta në grupin që merrnin trajtim .

E para nga dy meta-analizat shtesë raporto i të njëjtat rezultate si studimi origjinal.

E dyta meta-analizë e pacientëve (n=1,35), raporto i shkallën e incidencës së ABU-së nga 22% në muajin e parë dhe 32% gjatë vitit të parë pas transplantimit të veshkave.

Analiza nuk gjeti ndonjë lidhje midis ABU-së dhe pielonefritit akut të graftit (OR 1.8, 95% CI 0.78-1.79), një përfitim të trajtimit të ABU-së me antibiotikë mbi rrezikun e ITU (OR 1.08, 95% CI 0.63-1.84) ose një ndryshim të funksionit renal (ndryshimi mesatar në përqendrimin e kreatininës në serum - 0.03 mg/dL [95% CI 0.15-0.10]).

Prandaj, trajtimi i ABU-së te pacientët me transplant nuk rekomandohet.

3.2.4.4.5. Pacientët me disfunkcion-rekonstruksione të traktit urinar të poshtem

Pacientët me disfunkcionim i traktit urinar të poshtem (DTUP)- , (p.sh., disfunkcionim neurogjenik i traktit urinar të poshtem (NDTUP) sekondar në sklerozën multiple, pacientët me dëmtim të shtyllës kurrizore, pacientët me zbrazje jo të plotë të fshikëzës, pacientët duke përdorur kateterizim të pastër intermitent [KPI], ose pacientë me rindërtim të pjesës së ulët traktit urinar që përfshijnë (ileal conduits, orthotopic bladder replacement or continent reservoirs frequently become colonised.)

Një shqyrtim sistematik raporto i normat e prevalencës së ABU-së, që variojnë nga 25-86% për kanalet intestinale në 4 studime dhe 9,1-85% për neobladders orthotopic në 9 studime. Studimet treguan se trajtimi i ABU-së te ky grup i pacientëve nuk tregoi ndonjë benefit afatgjatë.

Për më tepër, në pacientët me DTUP që nuk zhvillojnë spontanisht ABU-në, kolonizimi i qëllimshëm me (*Escherichia coli* 83972) ka treguar një efekt mbrojtës kundër përsëritjeve simptomatike.

Prandaj, shqyrtimi dhe trajtimi i ABU-së në këto grupe pacientësh nuk është i rekomanduar. Nëse ky grup i pacientëve zhvillojnë ITU simptomatike rekurente , efektin e mundshëm mbrojtës të një ABU spontane të zhvilluar kundër ITU duhet të konsiderohet para ndonjë trajtimi.

3.2.4.4.6 Pacientët me kateter urinar

Pacientët me kateter suprapubik dhe me nefrostome, bëhen bartës së ABU-së në mënyrë të pandryshueshme, dhe trajtimi me antibiotik nuk tregon ndojnë benefit. Kjo është e zbatueshme edhe për pacientët me ABU dhe indëelling Stents ureteral. Trajtimi rutinor i bakteriurisë lidhur me kateterin nuk është i rekomanduar.

3.2.4.4.7. Pacientët me ABU të nënshtruar ndaj vendosjeve/shkëmbimeve të kateterit

Në pacientët që i nënshtrohen vendosjes/shkëmbimeve jokomplekse të katetrëve uretral indëelling, ABU nuk konsiderohet faktor rreziku dhe nuk duhet të kontrollohet ose të trajtohet. Në pacientët që i nënshtrohen vendosjes/shkëmbimeve të tubave të nefrostomisë dhe tstents uretidëelling, ABU konsiderohet një faktor rreziku për komplikime.

3.2.4.4.8. Pacientët e imuno-kompromituar dhe të sëmurë rëndë, pacientët me kandiduria

Këto grupe pacientësh duhen të shqyrtohen individualisht dhe përfitimi i shqyrtimit dhe trajtimit të ABU-së duhet të rishikohet në çdo rast. Trajtimi i candidurisë asimptomatike nuk është i rekomanduar.

3.2.4.5. Para procedurave kirurgjike urologjike

Në procedurat diagnostikuese edhe terapeutike që nuk hyjnë brenda në traktin urinar, ABU përgjithësisht nuk konsiderohet si një faktor rreziku, dhe shqyrtimi e trajtimi nuk konsiderohet i nevojshëm. Nga ana tjetër, në procedurat hyrëse në traktin urinar dhe prekja e mukozës, veçanërisht në kirurgjinë endoskopike urologjike, bakteriuria është një faktor rreziku.

Dy RCT dhe dy studime prospektive jo të randomizuara , e krahasuan efektin e trajtimit me antibiotik dhe trajtimin pa antibiotik para reseksionit transuretral të prostatës ose tumorit të fshikëzës.

Trajtimi me antibiotik reduktoi ndjeshëm numrin e ITU-ve simptomatike post-operative, krahasuar me pacientë që nuk u trajtuan me antibiotik, meta-analizën e dy RCT-ve (mesatarja RR 0.20, 95% CI 0.05 deri 0.86; n=167). Ethet dhe septikemia ishin gjithashtu dukshëm më të ulëta në rast të trajtimit me antibiotik krahasuar me pacientët që nuk ishin trajtuar, në dy RCT.

Një RCT duke përfshirë pacientët me dëmtime të shtyllës kurrizore në të cilët aplikohet urologji endoskopike, kirurgjitë nuk gjetën ndonjë ndryshim të rëndësishëm në normën e ITU-ve post-operative midis trajtimit afatshkurtër të ABU-së me antibiotik me një dozë ose dozë 3-5 ditore.

3.2.4.6. Para kirurgjisë ortopedike

Është gjetur një RCT (n=471) dhe një studim kohort multicentrik (n=303), që ka krahasuar trajtimin e ABU-së pa trajtim (pa antibiotik) para intervenimit kirurgjik ortopedik, (arthroplasty hip /hemiarthroplasty ose arthroplasty totale e gjurit). Asnjë nga studimet nuk treguan ndonjë efekt dobiprurës të trajtimit me antibiotik lidhur me inflamacionin në nyjën protetike (3.8% vs. 0% dhe 3.9% vs 4.7%, respektivisht).

Studimi kohort nuk raportoi ndonjë ndryshim të rëndësishëm në shkallën e ITU simptomatike post-operative (0,65% kundrejt 2,7%).

Një tjetër RCT hulumtoi efektin e trajtimit para-operativ të ABU-së me fosfomycin-trometamol për parandalimin e infeksioneve të hershme në nyjën protetike pas intervenimeve kirurgjike. Bakteriuria asimptomatike nuk ishte parashikuese e fillimit të inflamimit në nyjën protetike (OR: 1.06, 95% CI 0.33 - 3.38), dhe trajtimi i saj nuk modifikoi incidencën e hershme-PJI (OR: 1.03, 95% CI 0.15 - 7.10).

Për më tepër, katër meta-analiza shitesë nuk gjetën ndonjë përfitim lidhur me shqyrtimin apo trajtimin para-operativ të ABU-së para operacionit ortopedik. Prandaj, trajtimi i bakteriurisë nuk është i rekomanduar para kirurgjisë ortopedike.

3.2.4.7. Para operacioneve kardiokirurgjike

Është identifikuar, një rishikim sistematik dhe një meta-analizë duke përfshirë tri studime retrospektive non-randomised, duke përfshirë një numër total prej 1,116 pacientë. Procedurat e kryera ishin: bypass i arteries koronare (42%), zëvendësimet valvulare (51%) dhe operacionet e aortës torakale (7%).

Trajtimi paraoperativ i ABU-së në 116 pacientë nuk rezultoi me përfitim të konsiderueshëm në lidhje me shkallën e ITU-ve simptomatike (12.9% vs. 8.2%, p=0.086). Një heterogjenitet i moderuar është vërejtur në meta-analizën dhe trajtimin para operacionit të ABU, nuk kishte efekt të rëndësishëm në shkallën e komplikimeve infektive (OR: 1.38, 95% CI 0.56 – 3.39). Studime të mëtejshme me dizajn të përshtatshëm dhe numër më të madh të mostrës, nevojiten për t'i konfirmuar gjetjet e hulumtimeve të deritanishme.

3.2.4.8. Administrimi farmakologjik

Nëse merret vendimi për çrrënjosjen e ABU-së, e njëjta zgjedhje e antibiotikëve dhe kohëzgjatja e trajtimit si në infeksionet urinare simptomatike të pakomplikuara ose të komplikuara duhet të jepet, por duhet pasur parasysh gjininë, historinë e sëmundjes dhe faktorët e rrezikut. Trajtimi duhet të jetë i përshtatur dhe jo empirik.

3.2.5. Përcjellja

Nuk ka studime që fokusohen në përcjelljen pas trajtimit të ABU.

3.2.6. Përmbledhje e provave dhe rekomandimeve për menaxhimin e ABU

Përmbledhje e provave	Niveli i evidencave
Trajtimi i bakteriurisë asimptomatike nuk sjell dobi në situatat e mëposhtme: - te femrat pa ndonjë faktorë rreziku; - te pacientët me diabet mellitus të kontrolluar; - te femrat e moshës pas menopauzës; - te pacientët e moshuar, nëpër shtëpi pleqësh; - te pacientët me disfunktion / ose rekonstruktiv të traktit të poshtëm urinar; - te pacientët me transplant të veshkave; - te pacientët para trajtimeve kirurgjike ortopedike; - te pacientët para kirurgjive kardiovaskulare;	3b 1b 1a 1a 2b 1a 1a 1b
Trajtimi i bakteriurive asimptomatike është i dëmshëm te pacientët me infeksione urinare rekurente.	1b
Trajtimi i bakteriurisë asimptomatike është i dobishëm para procedurave urologjike që prekin mukozat.	1a
Trajtimi i bakteriurisë asimptomatike te gratë shtatzëna u zbulua se ishte i dobishëm nga meta-analiza; megjithatë, shumica e studimeve janë të vjetra. Një studim i fundit raportoi shkallë të ulët të pielonefritit te gratë me faktorë të ulët të rrezikut.	1a

3.2.6.1. Pyetje mjekësore: Në cilat raste nuk duhet trajtuar bakteriuria asimptomatike?

Rekomandimet	Vlerësimi
Mos trajto bakteriurinë asimptomatike në situatat e mëposhtme: - te femrat pa ndonjë faktorë rreziku; - pacientët me diabet mellitus të kontrolluar; - femrat e moshës pas menopauzës; - pacientët e moshuar, nëpër shtëpi pleqësh; - pacientët me disfunktion / ose rekonstruktiv të traktit të poshtëm urinar; - pacientët me transplant të veshkave; - pacientët para trajtimeve kirurgjike ortopedike; - pacientët para kirurgjive kardiovaskulare;	i forte
Mos trajto bakteriurinë asimptomatike te pacientët para procedurave kirurgjike kardiovaskulare.	E dobët
Të bëhet screeningu dhe të trajtohet bakteriuria asimptomatike para ndërhyrjeve kirurgjike urologjike që e prekin mikozën.	I forte
Të bëhet screeningu dhe të trajtohet bakteriuria asimptomatike te gratë shtatzëna me trajtim kohë-shkurtër ose me një dozë të vetme të fosfomicinit.	E dobët

3.3. Cistiti i pakomplikuar

3.3.1 Hyrje

Cistiti i pakomplikuar përkufizohet si cistiti akut, sporadik ose i përsëritur që ndodh te gratë joshatzëna që nuk kanë abnormalitete anatomike ose funksionale të njohura të traktit urinar ose komorbiditete.

3.3.2 Epidemiologjia, etiologjia

Pothuajse 50% e grave do të përjetojnë të paktën një episod cistiti gjatë jetës së tyre, me rreth një në tre gra që kanë përjetuar një episod deri në moshën 24-vjeçare.

Faktorët e rrezikut për cistitin e pakomplikuar përfshijnë; marrëdhëniet seksuale, përdorimin e spermicideve, një partner i ri seksual, një nënë me histori të infeksioneve të traktit urinar (ITU) dhe një histori të ITU-ve gjatë fëmijërisë.

Shumica e rasteve të cistitit të pakomplikuar shkaktohen nga *Escherichia coli* (E.coli).

3.3.3. Evaluimi diagnostik

3.3.3.1. Diagnoza klinike

Diagnoza e cistitit të pakomplikuar mund të bëhet me probabilitet të lartë duke u bazuar në një histori të simptomave të traktit urinar të poshtëm, siç janë: disuria, frekuenca dhe urgjenca, si dhe mungesa e shkarkimit vaginal. Te gratë e moshuara, simptomat gjenitourinare nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me cistitin.

3.3.3.2 Diagnoza diferenciale

Cistiti i pakomplikuar duhet të dallohet nga bakteriuria asimptomatike (ABU), e cila nuk konsiderohet infeksion, por më tepër një kolonizim komensal. ABU nuk duhet trajtuar ose skanuar, përveç në situata specifike ku konsiderohet faktor rreziku.

3.3.3.3. Diagnoza laboratorike

Te pacientët me simptoma tipike të cistitit të pakomplikuar, analiza e urinës (përfshirë kulturën e urinës dhe testimin me shkopinj dipstick) çon në një rritje minimale të saktësisë diagnostike. Megjithatë, analiza me shkopinj dipstick mund të rrisë probabilitetin e diagnozës së cistitit të pakomplikuar nëse diagnoza fillestare është e paqartë. Kultura e urinës rekomandohet për pacientët me simptoma atipike ose ata që nuk përgjigjen ndaj terapisë së duhur antimikrobike.

3.3.3.4 Përmbledhje e Provave dhe Rekomandimeve për Vlerësimin Diagnostik të Cistitit të Pakomplikuar?

Permbledhja e evidencave	NE
Diagnoza e saktë e cistitit të pakomplikuar mund të bazohet në anamnezë të fokusuar të simptomave të traktit të poshtëm urinar dhe mungesës së sekrecioneve vaginale ose irritimit.	2B

3.3.3.4.1. Pyetje mjekësore: Në çka bazohet diagnoza e cistitit të pakomplikuar te femrat?

Rekomandimet	Fuqia e rekomandimit
Diagnoza e cistitit të pakomplikuar te gratë që nuk kanë faktorë të tjerë rreziku për infeksione të komplikuara të traktit urinar bazohet në: • anamnezë e histori të fokusuar të simptomave të traktit të poshtëm urinar (dizuria, shpeshtësia dhe urgjenca); • mungesa e sekrecioneve vaginale.	I fortë
Përdorni testin me lakmues (dipstick) të urinës për diagnozën e cistitit akut të pakomplikuar.	I dobët
Urinokultura duhet të bëhet në situatat e mëposhtme: • Në rastet kur dyshohet për pielonefrit akut; • Në rastet kur simptomet nuk qetësohen ose përsëriten brenda katër javësh pas përfundimit të trajtimit; • Te gratë që paraqiten me simptoma atipike; • Te gratë shtatzëna.	I fortë

3.3.4. Menaxhimi i sëmundjes

Rekomandohet terapia antimikrobike, sepse suksesi klinik është dukshëm më i suksesshëm te gratë e trajtuara me antimikrobikë krahasuar me placebo . Te pacientet femra me simptoma të lehta deri të moderuara, terapia simptomatike (p.sh. Ibuprofeni, fitoterapia), si një alternativë ndaj trajtimit antimikrobik, mund të merret në konsideratë në konsultim me pacientet individual. Zgjedhja e terapisë antimikrobiale duhet të përcaktohet nga:

- spektri dhe modelet e ndjeshmërisë së patogjenëve etiologjikë;
- efikasiteti për indikacionin e veçantë në studimet klinike;
- tolerueshmeria dhe reaksionet anësore;
- efektet ekologjike të padëshirueshme;
- kostot;
- disponueshmëria.

Sipas këtyre parimeve dhe modeleve të ndjeshmërisë së disponueshme në Evropë, trajtimi oral me *fosfomicin trometamol* 3 gr. një dozë e vetme, *nitrofurantoin* (p.sh. nitrofurantoin monohidrat 100 mg dy herë në ditë, për pesë ditë) dhe **pivmecillinam (jashtë LEB)** duhet të merret në konsideratë si linjë e parë e trajtimit, kur është i disponueshëm .

Antimikrobikët alternativë përfshijnë trimetoprimin vetëm ose të kombinuar me një sulfonamid. Ko-trimoksazoli (160/800 mg dy herë në ditë, për tre ditë) ose trimetoprini (200 mg dy herë në ditë, për pesë ditë) duhet të merren në konsideratë si barna të zgjedhjes së parë vetëm në zonat me shkallë të njohur rezistence për *E. coli* < 20% .

Aminopenicilinat nuk janë më të përshtatshme për terapinë empirike për shkak të rezistencës së lartë të *E. coli* në të gjithë botën. Aminopenicilinat në kombinim me një inhibitor beta-laktamaze si; **ampicilina/sulbaktami (Jashtë LEB)** ose amoksisilina/klavulanati dhe cefalosporinat orale, nuk rekomandohen për terapinë empirike për shkak të dëmeve të padëshiruara ekologjike, por mund të përdoren në raste të zgjedhura.

Shënim i Rëndësishëm:

